

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: KOMUNA E MAMUSHËS

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr1 i prokurimit	626-21-7385-5-2-1
Nr i brendshëm	626-21-022-5-2-1

Sa i përket tenderit për: “Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugëve lokale në Mamushë”.

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

“AAB CONSTRUCTION SH.P.K. & BUJËR SHABANI BI”

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Luan Haradinaj Sol 1 Hy.1 nr.4

(Adresa)

Prishtinë

10 000

(Vendi)

(Kodi postar)

049-356-653

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Arlind Buzhala


(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

constructionaab@gmail.com

(Adresa elektronike)

05.11.2021

(Data e parashtrimit të kërkesës)



¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për Kontratë: 08.10.2021
Data e hapjes së ofertave: 19.10.2020
Letra standarde për tenderues të pasuksesshëm: 01.11.2021

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

☐

Jo

☐

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

☐

Jo

☐

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 64 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së.

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Të nderuar ne me dt. 01.10.2021 përmes platformës elektronike e-prokurimi jemi njoftuar me njoftimin mbi vendimin e AK-së ku e keni rekomanduar për kontratë Grupin e OE “SEFERI-CO SH.P.K.”, ndërsa neve na keni shpallur si tenderues të pasuksesshëm.

Ne pas kërkesës për qasje në dokumentacionin e ofertës fituese e ku na është lejuar qasja, kemi vërejtur se ju si AK keni rekomanduar për kontratë një OE i cili është i papërgjegjshëm dhe si i tillë i njëjti do të duhej të eliminohej nga ky aktivitet i prokurimit, e jo të shpallet të rekomandohet për kontratë.

Pra operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë nga ana juaj është i pa përgjegjshëm, për faktet si në vijim:

OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm sepse nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë përkatësisht kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale tek kapaciteti teknik e profesional pika 9.1 dhe 9.2 ku është kërkuar nga AK-ja : 2.4 Një (1) Inxhinier i infrastrukturës rrugore- Kërkohej që inxhinieri të ketë min. 3 vite përvojë pune – në angazhimet profesionale” ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar “Listën origjinale të punëtorëve të O.E. të nënshkruar dhe vulosur nga O.E. - Diplomat e inxhinierëve (kopje të noterizuar. Diplomat jashtë shtetit duhet të jenë të nostrifikuara) -Cv-të e inxhinierëve të nënshkruar nga inxhinieri (original ose kopje të noterizuar)”.

OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson këtë kërkesë sepse për të njëjtën kërkesë ka ofruar dëshmi për z.Armend Aliu kinse si inxhinier i infrastrukturës, mirëpo që në fakt z.Armend Aliu është me kualifikim **bachelor i shkencave** në inxhinieri ndërtimore dhe infrastrukturë.

Pra OE i rekomanduar për kontratë nuk e përmbush kërkesën e lartcekur në lidhje me inxhinierin e infrastrukturës, pasi që z.Armend Aliut i mungon kualifikimi i kërkuar në dosje së tenderit, andaj si i tillë OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka prezantuar inxhinierin e infrastrukturës dhe si i tillë kuptohet qartë se i njëjti është i papërgjegjshëm.

Gjithashtu faktin se OE i rekomanduar për kontratë nuk e përmbush kërkesën e dosjes së tenderit dhe është i papërgjegjshëm e keni vërtetuar edhe vetë ju si autoritet kontraktues, ku operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë ne letrën standarde për kërkesën për sqarim i keni kërkuar të ju sqaroj se *“Nëse posedoni dëshmi se Inxhinierin të cilin e keni paraqitur ka të përfunduar studimet master ose të keni një Inxhinier të infrastrukturës”* e ku OE i rekomanduar për kontratë është përgjigjur se *“nuk është kërkuar inxhinier me kualifikim master por inxhinier me 3 vite përvojë pune”*. Ndërsa dihet se kualifikimi master është ekuivalent i titullit inxhinier, kurse titulli bachelor nuk duhet ti merret parasysh për faktin se i njëjti nuk mund të quhet inxhinier (me tri vite studime) pa i përfunduar studimet në nivelin master. Pra me vet faktin se ju si AK i keni kërkuar sqarime të njëjtit në lidhje me studimet master ose inxhinier të infrastrukturës, kuptohet se i njëjti OE nuk e përmbush kërkesën në lidhje me inxhinierin e infrastrukturës, për faktin se ka prezantuar z.Armend Aliun me studime të nivelit bachelor, ku i njëjti nuk e posedon titullin inxhinier.

Mirëpo edhe vetë operatori ekonomik me sqarimet që i ka dhënë për inxhinierin në fjalë e ka pranuar që nuk ka Inxhinier të infrastrukturës rrugore, madje duke e cekur se në FDT nuk është kërkuar titulli master si kërkesë. Duke u bazuar edhe në këto sqarime kuptohet qartë se edhe vetë operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë e edhe vetë ju e keni konstatuar se i njëjti operator ekonomik nuk ka dëshmi për inxhinier të infrastrukturës.

Po të lejohej të ofertohej edhe me titullin bachelor normalisht që është dashur të shënohet tek kërkesa siç është shënuar për udhëheqësin e punishtes, prandaj OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar kërkesën në fjalë dhe tenderi i tij nuk është në përputhje të plotë me kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Andaj për ne është e çuditshme se si ka mundësi që ju si AK të njëjtit OE ti kërkonti sqarime në lidhje me inxhinierin e infrastrukturës dhe OE i rekomanduar për kontratë ju jep një përgjigje se kinse nuk është kërkuar që inxhinieri të jetë me titull master dhe ju e rekomandoni për kontratë edhe pse nuk ka ofruar fare dëshmi tjera në përgjigjen e tij në kërkesën për sqarime shtesë. Pra me këtë veprim tuajin shihet qartë favorizimi që i keni bërë OE të rekomanduar për kontratë edhe pse i njëjti është i papërgjegjshëm, ju e keni rekomanduar për kontratë.

Gjithashtu OE i rekomanduar për kontratë është i pa përgjegjshëm edhe për faktin se i njëjti nuk e plotëson edhe kërkesën tjetër të FDT-së tek kapaciteti teknik dhe profesional ku kërkesë ka qenë *“3.2 Një udhëheqës të punishtes inxhinier ose bachelor i ndërtimtarisë”*.

OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kërkesën e lartcekur për faktin se në lidhje me këtë kërkesë i njëjti ka prezantuar në ofertën e tij znj. Donjetë Berisha e cila është e

diplomuar në drejtimin/programin hidroteknikë. Dëshmia për Inxhinieren e prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë si udhëheqëse e punishtes nuk është konform kërkesës së lartcekur të dosjes së tenderit, për faktin se e njëjta inxhinierë, është e diplomuar në degën e hidroteknikës, pra jo ashtu siç është kërkuar në dosje të tenderit në drejtimin e ndërtimtarisë.

Pra kur kemi parasysh kërkesën e lartcekur ku është kërkuar inxhinier ose bachelor i ndërtimtarisë dhe znj. Donjetë Berisha ka diplomuar në drejtimin hidroteknikë, këtua kuptohet shumë qartë se inxhinierja e lartcekur nuk është ofruar konform kërkesës së dosjes së tenderit. Andaj duke u bazuar në faktin e lartcekur kuptohet se OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kërkesën e lartcekur dhe i njëjti është i papërgjegjshëm, mirëpo që një veprim të tillë ju si AK nuk e keni bërë, duke e favorizuar OE të rekomanduar për kontratë.

OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin se i njëjti nuk e plotëson edhe kërkesën tjetër të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë përkatësisht kërkesën nr.2.3 tek kapaciteti teknik dhe profesional ku kërkesë ka qenë *“2.3 Një inxhinier të diplomuar ose master i hidroteknikës-Kërkohet që inxhinieri të ketë së paku 3 vite përvojë pune”*.

I njëjti për kërkesën e lartcekur ka prezantuar znj. Adelina Zenelaj e cila është e diplomuar në drejtimin hidroteknikë dhe të njëjtës në diplomën e saj i shkruan se e ka marr titullin bachelor i ndërtimtarisë. Duke u bazuar në këtë fakt OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kërkesën e lartcekur për faktin se është kërkuar shumë qartë se duhet të ofrohet **Një inxhinier të diplomuar ose master i hidroteknikës**, ndërsa OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar një bachelor të ndërtimtarisë, e cila nuk është e diplomuar në nivelin master.

Andaj duke u bazuar në faktet e lartcekura shihet qartë se OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kërkesën e lartcekur për faktin se nuk është ofruar një inxhinier i diplomuar ose master, mirëpo është ofruar bachelor i ndërtimtarisë e cila nuk e posedon titullin inxhinierë, sepse është e qartë se titulli inxhinier fitohet me rastin e përfundimit të studimeve master. Andaj kështu siç ka ofertuar OE i rekomanduar për kontratë kuptohet qartë se i njëjti është i papërgjegjshëm dhe si i tillë është dashur të cilësohet edhe nga ana juaj mirëpo që një veprim të tillë ju si AK nuk e keni bërë, duke e shfaqur edhe një herë haptas favorizimin që i keni bërë OE të rekomanduar për kontratë.

Kur kemi parasysh të gjitha këto të meta në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë, atëherë vijmë në përfundim se tenderi i tije nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, prandaj është dashur të shpallet si tender i papërgjegjshëm pasi që paragrafi 4 i nenit 59 të LPP-së e përcakton saktë: *“Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”*

Prandaj ju si autoritet kontraktues keni vepruar në kundërshtim me këtë dispozitë ligjore.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë **tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.**

Gjithashtu ju nuk e keni respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, ku edhe pse ne jemi OE më i lirë dhe gjithashtu i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë nuk jemi rekomanduar për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që “Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse, mirëpo ju nuk i jeni përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Po ashtu ju si autoritet kontraktues nuk e keni pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet të cilat u cekën më lartë, kërkojmë nga ju si autoritet kontraktues që të nxjerrni:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e grupit OE “**AAB CONSTRUCTION SH.P.K. & BUJAR SHABANI BI**”

ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK-së për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në

RISHQYRTIM dhe gjatë rishqyrtimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t’iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim në vlerë prej 5,000.00 euro.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mospara-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*